



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nr. 3493/1 Prot.

Tiranë, më 25/5 /2020

URDHËR

Nr. 95 datë 25/5 /2020

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
"PËR PROCEDURAT E KONKURIMIT DHE PUNËSIMIT
PËR PUNONJËSIT ADMINISTRATIV DHE JO PJESË E SHËRBIMIT CIVIL NË
ADMINISTRATËN DOGANORE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ndryshuar, të nenit 15, pika 11, të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, pikës 6, të Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave "Për personelin e administratës doganore", të ndryshuar dhe pika 2, e nenit 29, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores "Për procedurat e konkurimit dhe punësimit për punonjësit administrativ dhe jo pjesë e shërbimit civil në administratën doganore".
2. Shfuqizimin e Urdhërit nr. 10, datë 05.02.2015, "Për miratimin e rregullores së konkursit për punonjësit administrativ të administratës doganore.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



RREGULLORE
"PËR PROCEDURAT E KONKURIMIT DHE PUNËSIMIT
PËR PUNONJËSIT ADMINISTRATIV DHE JO PJESË E SHËRBIMIT CIVIL NË
ADMINISTRATËN DOGANORE"

Neni 1
Të përgjithshme

Kjo rregullore përcakton:

- a) procedurat për shpalljen e konkurimit,
- b) përbërja e Komitetit të Përhershëm të Pranimit,
- c) fushën e veprimit të Komitetit të Përhershëm të Pranimit,
- ç) kriteret e pranimit,
- d) procedurat e konkurrimit,
- dh) marëdhëniet e punës,
- e) administrimin e dokumentacionit,

lidhur me konkurimin dhe punësimin e punonjësve administrativ dhe jo pjesë e shërbimit civil në administratën doganore.

Neni 2
Procedura e shpalljes së konkurimit

1. Procedura e konkurrimit dhe pranimit në punë të punonjësve, sipas përcaktimeve të shkronjave "a" dhe "b", të nenit 4, bëhet në përputhje me Kodin Doganor, Kodin e Punës dhe ligjit specifik, sipas rastit. Vendet e lira për këto kategori punonjësish, plotësohen në varësi të nevojave operationale dhe të natyrës së postit, nëpërmjet njërës prej procedurave të mëposhtme:
 - a) me transferimin e punonjësit brenda së njëjtës kategori,
 - b) me pranimin në punë, nëpërmjet procedurave të konkurimit të hapur.
2. Në zbatim të strukturës analitike në fuqi, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave (Titullari i institucionit), shpall vendet e lira të evidentuara dhe propozuara nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (DMBNJ).
3. Të gjitha vendet e lira publikohen nga DMBNJ, e cila kryen njoftimet për vendet e lira të punës për kategoritë, sipas përcaktimeve të shkronjave "a" dhe "b", të nenit 4, në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshëm të Doganave (DPD) www.dogana.gov.al.

4. Njoftimi për shpalljen e vendeve të lira të punës përmban:
 - i. numrin dhe vendndodhjen e vendeve të lira të punës;
 - ii. kushtet e veçanta për të marrë pjesë në konkurim;
 - iii. listën e dokumenteve që duhen paraqitur;
 - iv. procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes;
 - v. afatin dhe vendin e dorëzimit të dokumenteve;
 - vi. cilësitë e kërkuara për t'u pranuar në konkurim;
 - vii. ndonjë kërkesë të veçantë për ndonjë post të veçantë;
 - viii. datën, kohën dhe vendin ku do të kryhet konkurimi.

5. Afati për dorëzimin e dokumentave është 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e nesërme shpalljes së njoftimit në faqen zyrtare të DPD.

Neni 3

Përbërja e Komitetit të Përhershëm të Pranimit

1. Komiteti i Përhershëm i Pranimit për procedurën e konkurimit përbëhet nga:
 - a) një prej nëpunësve të kategorisë së mesme drejtuese, të DPD,
 - b) një përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
 - c) Drejtorin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

2. Përbërja e Komitetit, caktohet me Urdhër të Titullarit të institucionit.

Neni 4

Fusha e veprimit të Komitetit të Përhershëm të Pranimit

Komisioni i Përhershëm i Pranimit, realizon procedurat e konkurimit dhe pranimit të:

- a) personeli doganor për pozicionet e punës që nuk përfshihen në shërbimin civil,
- b) punonjësve administrativ Kategoria C3, D1, D2, (punonjës që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtjeje, shërbimi, ruajtjeje dhe që nuk përfshihet në pozicionet e shërbimit civil).

Neni 5

Kriteret e pranimit

Përmbushin kushtet e përgjithshme për t'u punësuar në administratën doganore, individët që:

- i. kanë shtetësi shqiptare;

- ii. kanë zotësi të plotë për të vepruar;
- iii. gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
- iv. nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë dhe që nuk po gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
- v. nuk kanë qenë larguar më parë nga administrata doganore ose shërbimi civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- vi. u nënshtrohen procedurave të konkurrimit specifikuar në nenin 6.

Neni 6

Procedura e konkurrimit

1. DMBNJ, administron procesin dhe fazat e procedurës së konkurrimit deri në pranim.
2. Procedura e konkurrimit zhvillohet në dy faza:
 - a) Faza parakualifikuese. Gjatë kësaj faze, shqyrtohet dhe vlerësohet dokumentacioni i paraqitur nga i interesuari, me qëllim verifikimin nëse plotësohen kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim;
Kjo fazë realizohet nga DMBNJ dhe dokumentohet me procesverbal.
Aplikantët që nuk arritën të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, skualifikohen dhe njoftohen individualisht nga njësia DMBNJ, duke evidentuar edhe arsyet e skualifikimit.
Lista e fituesve të fazës parakualifikuese, të shpallet në faqen zyrtare të internetit të DPD-së, brenda 10 ditëve kalendarike.
 - b) Faza e dytë. Aplikantët e kualifikuar për të vijuar me procedurën e konkurrimit, njoftohen individualisht nga DMBNJ, për vendin dhe orën e zhvillimit të konkurrimit. Ky afat shtyhet për arsye specifike vetëm me miratim të Titullarit të institucionit.
3. Komiteti i pranimit, dokumenton me procesverbal, pjesëmarrjen e aplikantëve në konkurim dhe rezultatet e arritura.
4. Aplikantët, vlerësohen bazuar në dosjen personale dhe me intervistë me gojë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e aplikantit.
Totali i pikëve të vlerësimit të aplikantëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
 - a) për vlerësimin e përvojës së aplikantit deri në 30 pikë,
 - b) për kualifikimin deri në 30 pikë,
 - c) për aftësitë e aplikantit deri në 40 pikë.

5. Komiteti i pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, liston kandidatët fitues me mbi 70 pikë, duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë.
6. Aplikantët e kualifikuar për fazën e dytë, të cilët nuk siguruan prezencën sipas njoftimit të sipërcituar, skualifikohen dhe njoftohen për këtë individualisht.
7. Lista me aplikantët fitues, shpallet në faqen zyrtare të internetit të DPD-së, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e zhillimit të konkurimit.
8. Aplikantët, mund të paraqesin, pranë Titullarit të institucionit, brenda 5 ditëve kalendarike, nga data e shpalljes së rezultateve të konkurimit, ankesë me shkrim, për zhvillimin dhe rezultatin e konkurimit. Përgjigjia mbi ankimin, kthehet brenda 10 ditëve kalendarike.

Neni 7

Marëdhënia e punës

1. Pas përfundimit të procedurave të ankimit sipas nenit 6, vijohet me fillimin e marrëdhënies së punës me aplikantët fitues me precedencë sipas listës dhe deklarata për praninë, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 2.
2. Aplikantët fitues me të cilët nuk është lidhur një kontratë pune, mbeten në listë pritje për një periudhë 1 vjeçare. Brenda kësaj periudhe nëse nga DMBNJ evidentohet vend i lirë dhe aplikanti në listë pritje plotëson kushtëzimet atëherë mundet të vijohet me procedurat e përcaktuara më sipër në këtë nen.
Pas kalimit të periudhës 1 vjeçare, aplikantët në listë pritje, kanë të drejtë të ri kandidojnë.

Neni 8

Administrimi i dokumentacionit

DMBNJ, siguron regjistrimin dhe dokumentimin në mënyrë të plotë, për të gjitha fazat e procedurave të konkurimit dhe pranimit. Të gjitha dokumentat, përfshirë vlerësimet përfundimtare të Komitetit gjatë intervistave, ruhen sipas legjislacionit “Për Arkivat” dhe Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD”.

Neni 9

Dispozita e fundit

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të DPD-së.